

Statuti i *JICA Alumini i Kosovës*

Ky statut do të të qeveris shoqatën jo-profitabile *JICA Alumini i Kosovës*, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1 – Emri, forma dhe adresa

- 1.1. Organizata do të quhet *JICA Alumini i Kosovës*
- 1.2. Ajo mund të njihet edhe si *JAAK*
- 1.3. Organizata është shoqatë jo-për përfitim, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- 1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.
- 1.5. Ndonjë transakcion në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
- 1.6. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në :
Rruga “ Afrim Zhitija, B13,H2, nr.11 Prishtinë

Neni 2 – Themeluesit

- 2.1. Themelues të organizatës janë:
 1. **Nezakete Hakaj “ A*****” **, * Prishtinë**
 2. **Halit Xhema “ B*****” * Skenderaj**
 3. **Servet Spahiu “ N*****” * Prishtinë**
- 2.2. Përfaqësues i autorizuar i organizatës në Kosovë është
 1. **Nezakete Hakaj “ A*****” **, * Prishtinë**
- 2.3. Përfaqësuesi i autorizuar emërohet nga Bordi i Drejtorëve dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjëse për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

Neni 3 – Qëllimi

- 3.1. Organizata është themeluar me qëllim të:
JICA Alumni Asociacioni i Republikës së Kosovës (këtu e tutje: JICA Alumni Asociacioni i Kosovës- JAAK) është organizatë, joqeveritare dhe jo fitimprurëse, me qëllim të arritjes së objektivave të definuara në këto marrëveshje të Asociacionit, duke stimuluar marrëdhëniet miqësore në mes studenteve dhe të trajnuarëve të mëparshëm nga Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (këtu e tutje; JICA) nga Republika e Kosovës dhe vendet e tjera në zhvillim, përkrahjen e shkëmbimeve kulturore dhe filantropike dhe mundësinë e implementimit të programeve zhvillimore të JICA në Republikën e Kosovës
- 3.2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:
 - ◇ ***organizimin e ekspertëve, sesione specifike dhe këshilluese, debate publike, sesione të tavolive të rrumbullakta dhe takime të tjera;***
 - ◇ ***organizimin e forumeve, seminareve, kurseve dhe formave tjera të edukimit me qëllim të të promovimit të njohurive për bashkëpunim teknik me Japoninë; këto aktivitete të mëtejme do të regjistrohen me organet relevante;***

- ◇ *organizimin e aktiviteteve publikuese, publikimin e revistës së ekspertëve, monografi, krijimin e projekteve hulumtuese dhe mësuarje të aktiviteteve tjera të ekspertëve me informata nga fushat e shkencës, teknologjisë dhe biznesit në lidhje me bashkpunimin teknik me Japonin; këto aktivitete të mëtejme do të regjistrohen me organet relevante;*
- ◇ *organizimin e aktiviteteve kulturore dhe aktiviteteve tjera dhe manifestimeve të cilat do të kontribuojn në promovimin e marrëdhënjeve miqësore dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis Japonisë dhe Republikës së Kosovës*

Neni 4 – Anëtarësimi

4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.

4.2. Kuvendi i anëtarve do të vendos nëse do të kërkohet pagimi i anëtarimit nga anëtarët. Mospagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga organizata.

4.3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të :

- a. në dështimin e anëtarësimin, te paguhen taksat e anëtarësimin, përmes periudhës që kalon një vit kalendarik*
- b. regjistrimin me shkrim i anëtarit*
- c. ne rast vdekje te anëtarit ose humbjen e aftësisë së punës*
- d. pas seancave të kaluara në zyrën për krime e cila është, sa i përket opinionit të bordit ekzekutiv, siç janë vdekjet e natyrshme që duhet të rezultojë me përfundimin e anëtarësimin*
- e. me përjashtimin e anëtarit për arsyet të cilat janë, sa i përket vlerësimeve të Bordit Ekzekutiv, në të kundërtën në interes të Asociacionit dhe mund të kërcënoje reputacionin e saj.*

Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.

4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimin nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5 – Kuvendi i Anëtarëve

5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.

5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.

5.3. Përpos kompetencave që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ai gjithashtu ka edhe këto kompetenca:

- a. miraton Nenet e Asociacionit dhe merr vendime për ndryshimet dhe amendamentet e Neneve të Asociacionit me 2/3 e votave shumicë të anëtarëve prezent;*
- b. diskuton dhe vendos për çështjet e përgjithshme në lidhje me arritjen e objektivave të Asociacionit dhe të punës së organeve;*
- c. emëron dhe shkarkon nga detyra Presidentin e Asociacionit me 2/3 e votave shumicë të anëtarëve prezent;*
- d. emëron dhe shkarkon nga detyra anëtarët e Bordit Ekzekutiv të Asociacionit me 2/3 e votave shumice të anëtarëve prezent*
- e. emëron dhe shkarkon nga detyra Sekretarin e Asociacionit me 2/3 e votave shumice të anëtarëve prezent;*

- f. emëron dhe shkarkon nga detyra anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të Asociacionit me 2/3 e votave shumicë të anëtarëve prezent;**
- g. merr vendime mbi ndërprerjen e punës së Asociacionit në pajtim me ligjin, me 2/3 e votave shumicë të anëtarëve prezent;**
- h. miraton Librin e Rregullave të Asociacionit;**
- i. udhëheqë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me qëllimin e arritjes së objektivave të Asociacionit dhe punën udhëheqëse të Organeve të Asociacionit.**

5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e drejtorëve ose ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni 6 – Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

- 6.1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku dy herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
- 6.2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga (*gjysma e anëtarëve*) ose nga Bordi i drejtorëve. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Sekretarit i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.
- 6.3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku (*shtatë*) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.4. Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarrja e 50% + 1 e anëtarëve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.
- 6.5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
- 6.6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
- 6.7. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 7 – Bordi i Drejtorëve

- 7.1. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve duhet të jetë përgjegjës për kontrollin dhe udhëheqjen e çështjeve dhe pasurisë së organizatës. Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.
- 7.2. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

- a. Ekzekutoj vendime dhe qëndrimet e Takimit,**
- b. Të miratoj programin e punës së Asociacionit,**
- c. Të emëroj anëtarët dhe të themeloj organet kryesore dhe punuese të Asociacionit,**
- d. Të menaxhoj punën e Asociacionit dhe të siguroj arritjen e objektivave të Asociacionit,**
- e. Të marr vendime për organizimin e sesioneve këshilluese nga ekspertët, seminareve, forumeve, ligjëratave dhe formave tjera të aktiviteteve të kualifikuara të Asociacionit,**
- f. Të vendos për programet për bashkëpunim ndërkombëtar dhe të vendos për bashkim me asociacione ndërkombëtare,**
- g. Të përgatis sesionet e Takimit,**
- h. Të propozoj ndryshime dhe amendamente për Nenet e Asociacionit nga Takimi,**
- i. Të vendos për mënyrën e organizimit të aktiviteteve publikuese,**
- j. Të marr vendime për ndryshimin e shumës së taksës për anëtarësim me 2/3 e votave shumicë të anëtarëve prezent,**

- k. Të vendos për caktimin e statusit për anëtar nderi të Asociacionit, të miratoj planet financiare dhe raportet finale të Asociacionit, miratoj Librin e Rregullave mbi punën e vet,*
- l. Të vendos për shfrytëzimin dhe alokimin e fondeve dhe asetëve të Asociacionit me 2/3 e votave të anëtarëve prezent,*
- m. Të kryej punë të tjera, të nevojshme për arritjen e objektivave të Asociacionit, dhe*
- n. Të mundësoj punën e organeve të Asociacionit.*

7.3. Bordi i Drejtorëve zgjedhet nga anëtarët e organizatës. Ata do të zgjidhen individualisht nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm. Drejtori zgjedhet në kohëzgjatje prej (një) viti dhe do të ushtroj detyrën deri në zgjedhjen e drejtorit të ri.

Mandati (kontrata) e punës mund të pushoj: në rast vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra

7.4. Bordi i Drejtorëve do të ketë të paktën 3 (tre) anëtarë: Kryetarin, Sekretarin dhe Arkatarin.

7.5. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve **mund** të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

7.6. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.

7.7. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të Bordit të Drejtorëve, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.

7.8. Vendimet në Bordin e Drejtorëve merren me shumicë.

7.9. Bordi i Drejtorëve mund të vendos t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

7.10. Kurrëfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet drejtorëve pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompenzimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

7.11. Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 8 – Zyrtarët dhe Nëpunësit

8.1. Në rast nevoje Bordi i Drejtorëve do të emërojë Zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet nga Bordi i Drejtorëve, i cili duhet të informojë Kuvendin e Anëtarëve për emërime të tilla.

8.2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm punën e kryer për organizatë.

Neni 9 – Shpërbërja e organizatës

9.1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

9.2. Kur të vendos për shpërbërjen e organizatës, kuvendi i anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse organizata.

Neni 10 – Ndryshimet e statutit

10.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e *dy të tretave* të shumicës së Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11 – Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

11.1. Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

11.2. Viti financiar i organizatës do të përpulhet me vitin kalendarik.

Ky statut është aprovuar në *Prishtinë*

Më 19.5.2009

Nga themeluesit e organizatës

1. *Nezaket Hakaj* _____
2. *Halit Xhema* _____
3. *Servet Spahiu* _____